


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i fau Broj strana Nr. pages	03
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-2679/15
Data Datum Date	09.09.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08/09/2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKPP – 03-03/2554/15
PËR/ZA/TO:	znj. Elmaze XHEMA Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Financave
CC:	z. Naim BAFTIU Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “ Analizimi dhe Dokumentimi i Proceseve të Punës së TI-së dhe Zhvillimin e Planit për Implementimin e ITIL në Departamentin e Menaxhimit të Sistemeve të TI-së në Ministrinë e Financave “

E nderuar znj. XHEMA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik, lidhur me tenderin “Analizimi dhe Dokumentimi i Proceseve të Punës së TI-së dhe Zhvillimin e Planit për Implementimin e ITIL në Departamentin e Menaxhimit të Sistemeve të TI-së në Ministrinë e Financave” me numër prokurimi: G2G 201/15/03/221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin “Analizimi dhe Dokumentimi i Proceseve të Punës së TI-së dhe Zhvillimin e Planit për Implementimin e ITIL në Departamentin e Menaxhimit të Sistemeve të TI-së në Ministrinë e Financave” me numër prokurimi: G2G 201/15/03/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y c t i m

Ministria e Financave, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull: “Analizimi dhe Dokumentimi i Proceseve të Punës së TI-së dhe Zhvillimin e Planit për Implementimin e ITIL në Departamentin e Menaxhimit të Sistemeve të TI-së në Ministrinë e Financave” me numër prokurimi: G2G 201/15/03/221 i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më datë: 24/08/2015 në Procedurën e Hapur – Ri tender. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurim Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, Agjencia Kundër Korrupsion ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 24/08/2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkesa 1 Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: *Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku 6 vjet përvojë relevante në implementimin e projekteve të përgjithshme të konsulencës brenda ose jashtë Kosovës të dëshmuar me referenca nga klientët e kompanisë*, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik. Sipas LPP-së, një Autoritet kontraktues mundet të kërkojë dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat duhet t'i referohet maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet asnjë mënyrë të kalojë këtë kufizim prej tri viteve.

Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kritere i ka vendosur **1. Përvoja relevante e Operatorëve Ekonomik në menaxhimin e projekteve të konsulencës (bazuar në referencat e OE për angazhimin në punë të përgjithshme të konsulencës në minimum 6 vitet e fundit) 10 %**; **2. Përshtatshmëria e metodologjisë së propozuar në realizimin e projektit dhe plani dinamik 30 %**; **3. Përvoja specifike e ekspertit të propozuar në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për dokumentimin e proceseve të punës së TI-së dhe zhvillimin e Planit për implementimin e ITIL (minimum 6 vite) me 50 %**; dhe 4. Metodologjia e transferimit të njohurive dhe trajnimeve nga ana e ekspertit. Lidhur me nën kritere 1 dhe 3 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas ligjit të prokurimit publik kritere të përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kritere për dhënie të kontratës. Tenderuesit do të



konsiderohen të kenë përmbushur kërkesat minimale në lidhje me kapacitetet e tyre për të performuar kontratën që do të thotë që kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk mund të përdoren si kritere në procesin e dhënies së kontratës.

Agjencia Kundër Korrupsion gjithashtu konsideron se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje procedurale në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, duke përdorur procedurën e hapur për këtë aktivitet të prokurimit. Sipas legjislacionit në fuqi për Prokurim Publik, Shërbimet e Konsulencës duhet të zbatohen përmes procedurës së kufizuar. Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se Njësia e Kërkesës i ka propozuar gjithashtu edhe kriteret e përzgjedhjes, e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Në udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, përcaktohen qartë funksionet e njësisë kërkuese dhe njësisë së prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **52** Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të LPP; nenin **23** Kriteret e përzgjedhjes; Neni **9** Funksionet e Njësisë së Kërkesës; dhe nenit **53** Shërbimet e Konsulencës nga Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

